



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:089844

Datë: 28.06.2019

Numri i dokumentit: 00383640

C.nr.102/2016

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mevlide Shabani, me bashkëpunatorin profesional Baki Sylejmani, duke vendosur në procedurën kontestimore të paditësit Sh.B nga Gjilani, të cilin e përfaqëson me autorizim A.A.K, av. nga Prishtina, rr. “..”, hymja ..., nr. ..., kundër të paditurës Raiffeisen Bank Kosovë, IJ.S.C (RBKO), me seli në Prishtinë, rr. “UÇK”-së, nr. 51, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.N, jurist nga Gjilani, me objekt kontesti, pasurimi i pa bazë, në seancën gjyqësore dhe publike të datës 19.04.2019 mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh.B nga Gjilani kundër të paditurës Raiffeisen Bank Kosovë me seli në Prishtinë dhe OBLIGOHET e paditura, që paditësit t’ia bëj kompensimin e dëmit në emër të dëmit të shkaktuar për shkak të fitimit të pabazë për vlerat e llogaritura më tepër nga e paditura edhe atë

I. për produktin e kredisë 1854, shumën në vlerë prej .....9.879,72 €

II. për produktin e kredisë 13321, shumën në vlerë prej .....20.454,07€

III. për kamatën në periudhën kohore 15.08.2008 deri më 11.03.2019, shumën prej 21.665,91 €

Gjithsej shumën e përgjithshme prej 51.665,91 €

Të gjitha në kamatë në lartësi prej 8 % duke filluar nga dita e dorëzimit të padisë në gjykatë gjer në pagesën përfundimtare.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej ....€ të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi Sh.B nga Gjilani, në këtë gjykatë më date 06.01.2016, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, ka ushtruar padi ndaj të paditurës Raiffaisen Bank Kosovë me seli në Prishtinë, për shkak të pasurimit pa bazë juridike.

I njëjti në padi ka theksuar se me të paditurën më dt. 25.06.2005 kanë lidhur kontratat mbi kredinë nr. .. për shumën prej 77.216,26 €për lindjen e kredisë ... për shumën prej 51.715,74 € dhe kredinë nr. ... për shumën prej 174.314,29 € sipas të cilit paditësit do ti kthej paratë në shumën e caktuar sipas kontratave të lartcekura e që shuma e përgjithshme e borxhit që është dashur të kthehet është 303 mijë euro përfshirë kamatat e rregullta dhe ato ndëshkuese të kërkuara me propozimin për përmbarim të dt. 09.08.2007. Pasi që paditësi kishte filluar pagimin e borxheve dhe kthimin e kredisë me ç’rast nuk është kryer përmbarimi, kreditori Raiffeisen Bank ka vazhduar me aplikimin e kamatave ndëshkuese përveç atyre të rregullta, të cilat edhe pse janë të kontraktuara janë të ndaluara me ligj (neni 379 i LMD-kamata mbi kamatë) ku vlera e përgjithshme e saj është 46 mijë euro. Bazuar në këto fakte ka kërkuar nga gjykata ta aprovoj kërkesëpadinë e tij dhe ta obligoj të paditurën që paditësit tia paguaj shumën

prej 45 mijë euro me kamatën e paraparë ligjore duke filluar nga dita e ngritjes së kësaj padie gjer në pagimin definitive të saj si dhe të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Me parashtrësën e dt.18.04.2019 i autorizuari i paditësit pas pranimit të ekspertizës nga ana e ekspertit financiar ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata që të obligohet e paditura, që paditësit t'ia bëjë kompensimin e dëmit në emër të dëmit të shkaktuar për shkak të fitimit të pabazë për vlerat e llogaritura më tepër nga e paditura edhe atë: për produktin e kredisë ..., shumën në vlerë prej 9.879,72 € për produktin e kredisë ..., shumën në vlerë prej 20.454,07€, për kamatën në periudhën kohore 15.08.2008 deri më 11.03.2019, shumën prej 21.665,91 € Gjithsejtë shumën e përgjithshme prej 51.665,91 € të gjitha në kamatë në lartësi prej 8 % duke filluar nga dita e dorëzimit të padisë në gjykatë gjer në pagesën përfundimtare. Gjithashtu i njëjti i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi më dt. 18.05.2017, ku e paditura e ka pranuar më dt. 19.05.2017, e cila datë është konfirmuar përmes fletëkthesës e cila gjendet në shkresat e lëndës. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do ti ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, për mundësinë që gjykata të marrë aktvendim për shkak të mosbindjes.

E paditura Raiffeisen Bank Kosovë me seli në Prishtinë, në përgjigjen në padi në tërësi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke theksuar se kërkesa e paditësit ka parashkrim absolut bazuar në LMD gjegjësisht nenit 325, 353, pika 1, 354, 355 dhe 357, Ligji nr. 04/L-077.

Përfaqësuesi i paditësit, si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave pa asnjë dyshim u vërtetua kërkesëpadia e paditësit si nga baza ashtu edhe nga lartësia pasiqë marrëveshjet mbi huanë-kreditin të cilat ishin të nënshkruara në mes të palëve ndërgjyqëse që kanë të bëjnë me kamatën ndëshkuese për vonesë në marrëveshjet e nënshkruara janë përcaktuar në kundërshtim me nenet 10, 12, 14, 15, 16, 103, 277, 279, par. 2, dhe 399 të LMD-së, dhe si pasojë e këtyre veprimeve të kundërligjshme e paditura ishte pasuruar pa bazë dhe sipas dispozitës së nenit 211 të LMD-së, e paditura është e detyruar që shumën për të cilën është pasuruar pa bazë të ia kthejë paditësit. Faktin se e paditura është pasuruar pa bazë në shumën prej 51.665,91 € ka të bëjë me kamatat ndëshkuese të cilat janë marrur në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase marrëveshjen mbi huanë-kreditin është kontraktuar shkalla e kamatës mujore prej 3 % për çdo muaj vonesë ose 36 % në vit, për këstet e papaguara të kredisë ashtu që këto dispozita janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 270, par. 3 të LMD-së, sipas të cilës ndëshkimi kontraktues nuk mund të kontraktohet në të holla, e cila dispozitë është e natyrës imperativë kështu që pasiqë kamata ndëshkuese përmban ndëshkim të kontraktuar ajo nuk mund të ketë efekt juridik, prandaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi dhe atë sipas parashtrësës mbi precizimin e kërkesëpadisë si dhe shpenzimet gjyqësore të specifikuar në parashtrësën e precizimit të kërkesëpadisë të cilat janë konform TA-së.

Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës B.N, si në shqyrtimin përgatitor, kryesor, ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi të ushtruar me shkrim në këtë gjykatë, me të cilën e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit për shkak se kërkesa e paditësit ka parashkrim absolut bazuar në LMD gjegjësisht nenit 325, 353, pika 1, 354, 355 dhe 357, Ligji nr. 04/L-077. Ka vlerësuar se llogaritja e borxhit për secilën kredimarrës monitorohet dhe kontrollon në mënyrë shumë të rreptë nga ana e Rregullatorit të BQK-së dhe probabiliteti për gabime në llogaritje është i pamundur. Në fund i njëjti ka kërkuar nga Gjykata që ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Gjykata ka lexuar dhe administruar këto prova: Kërkesa për përmbarim e të paditurës i dt.09.08.2007 lëshuar nga Gjykata Komunale në Gjilan, Propozimin për sekuestrim të

kolateralit i dt.09.08.2007, Pasqyra finaciare e paditësit i dt.02.10.2014, Ekspertiza finaciare e dt.26.10.2018 e punuar nga eksperti gjyqsore financiar V.I, Marrëveshja mbi kredinë nr.... i muajt nëntor 2005 së bashku me Marveshjen mbi pengun, Marrveshja kryesore nr. .. i dt.23 nëntor 2005 së bashku me marrëveshjen mbi pengun, Ekspertiza e ekspertit fianciar I.T e dt.11.03.2019 si dhe plotësimi i ekspertizës i dt.17.04.2019, Aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë II.C.nr.272/2011 i dt. 30.01.2012, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ae.nr.352/2012 i dt. 07.06.2013, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev.nr.24/2013 i dt. 05.02.2014.

IT i dëgjuar në cilësi të ekspertit financiar në mes tjerash ka deklaruar se i njëjti këtë ekspertizë e ka hartuar duke u bazuar në Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan dhe në bashkëpunim të plotë me palët në kontest përkatësisht me paditësin Sh.Bdhe të paditurin Raiffeisen Bank Dega në Gjilan dhe Qendra në Prishtinë. Gjatë ekspertizës ka ekzaminuar të gjitha kreditë dhe linjat kreditore dhe janë prezentuar të gjitha obligimet dhe pagesat e bëra ne emër te këtyre kredive dhe linjave kreditore, të gjitha obligimet e dala nga këto kredi dhe pagesat e bëra janë të harmonizuara me pasqyrën e obligimeve dhe pagesave të cilat të njëjtit i janë prezentuar nga e paditura, pasqyrë të cilën i njëjti ia ka bashkangjitur shkresave të lëndës. Poashtu i njëjti është obliguar nga Gjykata Themelore në Gjilanqë të bëjë përlllogaritjen e kamatës për shumën e përgjithshme prej gjithsej 30.333,79 €duke filluar nga dt. 15.08.2008 e deri në përfundimin e ekspertizës më dt. 11.03.2019, të gjitha këto në afat prej 3 ditësh. Eksperti financiar më dt. 17.04.2019 ka bërë llogaritjen e kamatës vjetore ku shuma bazë për llogaritje ka qenë 30.333,79 €ndërsa periudha kohore për llogaritje është prej dt. 15.08.2008 deri më 11.03.2019 dhe kamata e llogaritur gjithsej është 21.665,91 €

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në në kuptim të nenit 8 të LPK-ës dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestimore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: Se më datë 29 qershor 2005 është lidhur marrëveshja mbi kredinë – pengun, hipotekën dhe garancionin me nr. ... , ndërmjet Raiffeisen Bank Kosovë J.S.C kredidhënësi dhe kompanisë “B...” të përfaqësuar nga Sh.B, S.B, bashkëshortja e kredimarrësit, S.A garantues, dhe Sh.B..1 garantues, ku kredidhënësi i ka lejuar kredimarrësit ri-strukturimin e kredisë në shumë prej 92,030.30 € ku afati i kthimit të kredisë nga dt. e lëshimit përfshirë edhe muajt e ristrukturuar është deri më dt. 24.09.2009, me kamatë vjetore të kredisë së ristrukturuar në shumë prej 13.5 € Poashtu më dt. 29.05.2005 është lidhur marrëveshja mbi kredinë – pengun, hipotekën dhe garancionin me nr. 11854, ndërmjet Raiffeisen Bank Kosovë J.S.C kredidhënësi dhe kompanisë “B...” të përfaqësuar nga Sh. B, S.B, bashkëshortja e kredimarrësit, S.A garantues, ku kredidhënësi i ka dhënë kredimarrësit kredi në shumë prej 250,000 € afati për kthimin e kësaj kredie ishte 24 muaj, ndërsa lartësia e kamatës është 13.5 €në vit. Poashtu më dt. 19.01.2005 është lidhur marrëveshja mbi kredinë me nr. 13321 në kuadër të Marrëveshjes kryesore nr. 6 ku kredidhënës ka qenë Raiffeisen Bank Kosovë J.S.C kredidhënësi ndërsa kredimarrës ka qenë NTP “B..” i përfaqësuar nga Sh.B, S.B, bashkëshortja e kredimarrësit, dhe H.Sh garantues, ku kredidhënësi i ka dhënë kredimarrësit kredi në shumë prej 265,000 € afati për kthimin e kësaj kredie ishte 24 muaj, ndërsa lartësia e kamatës është llogaritë 13.5 €në vit, ku nga pagesat e paditësit përveç borxhit, kryegjësë të kërkuar përmes procedurës përmbartimore të njëjtit kanë aplikuar edhe kamatën ndëshkuese të cilat edhe pse janë kontraktuar janë të ndaluara me ligj (kamata mbi kamatë), ku vlera e përgjithshme e saj është 44 mijë euro.

Nga ekspertiza finaciare e ekspertit gjyqsor V.I e dt. 26.10.2018 gjykata vërtetoi faktin se për produktin e kredisë .. RBKO ka llogaritur më tepër kamatë të rregullt në vlerë prej 13,177.86 € kamatëvonesë në vlerë prej 5,890.95 € e që në total bëjnë 19,068.81 € për produktin e kredisë ... RBK ka llogaritur më tepër për kamatë të rregullt shumën prej 26,112.50 € kamatëvonesë në vlerë prej 4,668.68 € e që në total kapin shumën prej 30,781.18 €

Nga ekspertiza financiare e ekspertit financiar I.T gjykata vërtetoi faktin se përlogaritja e kamatës ndëshkuese dhe pagesave është për marrëveshjen kreditore nr. ... në shumë prej 77,216.26 € linja e kredisë nr. .... në shumë prej 51.715,74 € kredia nr. .... për shumë prej 174,314.29 € poashtu eksperti financiar ka bërë plotësimin e llogaritjes së kamatës vjetore në shumën bazë prej 30,333.79 € për periudhën kohore nga dt. 15.03.2008 deri më 11.03.2019 ku kamata e llogaritur është 21.665,91 € e që shuma e përgjithshme 51,665.91 €

Gjykata pas analizimit dhe shtjellimit të shkesave të lëndës e aprovoi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar me ligj dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar me ligj edhe ate duke u bazuar në nenin 210 i LMD- së vitit 1978 ku parashihet se “*Në qoftë se mjete shoqëror që drejtohet nga punëtorët, respektivisht nga punonjësit e tjerë, pranë personit të caktuar shoqëror juridik ka kaluar në cilëndo mënyrë qoftë në mjete shoqërore që drejtohen nga punëtorët, respektivisht punonjësit e tjerë pranë personit tjetër shoqëror juridik, ose në posedim të ndonjë personi, kurse ky kalim nuk bazohet në ndonjë marrëveshje vetëqeverisëse pse në ndonjë veprim tjetër juridik apo me ligj fituesi ka për detyrë ta kthejë në qoftë se kjo është e mundur, por edhe ashtu e ka për detyrë ta kompensojë vlerën e përfitimit të krijuar*”, si dhe duke u bazuar në nenin 270, par. 3 të LMD të vitit 1978 ku parashihet se “*Dënimi kontraktues nuk mund të kontraktohet për detyrimet në të holla*”, e në rastin konkret gjykata e ka detyruar të paditurën e cila është pasuruar pa bazë që tia kthej paditësit shumën e të hollave në lartësi prej 51,665.91 € që ka të bëj me kamatat ndëshkuese (anatocizmi) të cilat janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale ngase në marrëveshjen mbi huanë-kreditë është kontraktuar shkalla e kamatës mujore prej 3 % për çdo muaj vonesë ose 36 % në vit për këstet e papaguara të kredisë ashtu që këto dispozita janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 270, par. 3 të LMD/1978 andaj edhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi konform nenit 452.1 të LPK, ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit tia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore edhe atë: në emër të ekspertit financiar shumën prej 301 € taksë gjyqësore ..., për çdo përfaqësim në seancë gjyqësore shumën prej 270 € ... , të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbamrimit të dhunshëm.

Kamata në vlerë prej 8 % është llogaritur konform nenit 382 të LMD të vitit 2012.

Nga të cekurat më lartë, e në bazë të nenit 143 të LPK-ës dhe nenit 210 dhe 270, par. 3 të LMD të vitit 1978, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

C.nr.102/16, datë 19.04.2019

Gjyqtarja,  
Mevlide Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi.